

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë në çështjen juridike të paditëses Kompania e Sigurimeve “SUISSE MOBILIAR” CH 300, Bern, Bundesgasse 35, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit B.N., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Fondi i Kompensimit, tani Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit-kasko regres, në shumën e përgjithshme prej 6,637.50 €, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, III.EK.nr.142/14, të datës 24.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26.02.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, III.EK.nr.142/14, i datës 24.10.2016, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Kompania e Sigurimeve “SUISSE MOBILIAR” CH 300, Bern, Bundesgasse 35, ashtu që në paragrafin I të dispozitivit, e ka detyruar të paditurën Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të regresit nga baza e sigurimit auto kasko të datës 11.08.2012, t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 6,637.50 €, me kamatë vjetore prej 12%, duke llogaritur nga data 07.08.2013, e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afatin parativ prej 7 ditësh, nga data e pranimit të këtij aktgjykimi, ndërsa në paragrafin II të dispozitivit, ka detyruar të paditurën që në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 1,493.60 €, në afatin prej 7 ditësh, duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë ta prishë dhe kërkesën e palës paditëse ta refuzoj si të pabazuar në ligj.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK , gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Paditësja Kompania e Sigurimeve “SUISSE MOBILIAR” CH 300, Bern, Bundesgasse 35, me datën 24.02.2014, pranë gjykatës së shkallës së parë ka parashtruar padi kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, më të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që në emër të regresit nga baza e sigurimit auto kasko, nga aksidenti i datës 11.08.2012, paditëses t'i paguaj regresin në shumë prej 11,297.60 CHF, me kamatë ndëshkuese prej 12%, duke filluar nga data 11.08.2012, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit meqenëse e paditura nuk e ka kundërshtuar bazën juridike të kërkesëpadisë, përkatësisht ka pranuar përgjegjësinë për bazën juridike të rimbursimit lidhur me kompensimin e dëmit-regres, por vetëm lartësinë e kompensimit të kërkuar. Gjykata e shkallës së parë vlerësimin e vet e ka mbështetur në konstatimin e ekspertit të makinerisë, për vlerësimin e dëmit Nexhmi Shala, të dhënë në ekspertizën teknike të datës 30.09.2016, sipas të cilit ka rezultuar se lartësia e dëmit të pësuar, saktësisht kostoja e riparimit të automjetit, është në shumën prej 8,623.52 CHF ose 7,895.50 €, andaj gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 939 par.1 të LMD-së, me të cilin është përcaktuar *“se me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin, në bazë të vet ligjit, deri në shumën e kompensimit të paguar, të gjitha të drejtat e të siguruarit ndaj personit i cili mbi cilën bazë qoftë është përgjegjës për dëmin”*, pasi që nga provat e administruara është vërtetuar që paditësi i ka kompensuar të siguruarit të saj dëmin shkaktuar në automjetin e siguar mbi bazën e sigurimit kasko, poashtu automjeti i personit që ka qenë shkaktar i aksidentit nuk ka poseduar sigurim valid nga autopërgjegjësia, andaj bazuar në të lartëcekurat dhe nenin 18 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, me të cilin përcaktohet se: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit*

nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjesisë, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”, ekziston obligimi i të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve në kompensimin e dëmit dhe e drejta e paditësit në rimbursimin e shumës së paguar.

Gjykata e Apelit i shqyrtoj pretendimet ankimore të paditurës në lidhje me kompensimin e dëmit të dëmtuarit Rasim Morina, nga e paditura, i cili ka rrjedhë nga Ujdia Jashtëgjyqësore dhe se për këtë arsye paditësi nuk ka të drejtë të kërkojë rimbursim, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse duke u bazuar në nenin 190 të LMD-së, me të cilin është përcaktuar se ”Gjykata duke marrë parasysh edhe rrethanat që kanë lindur pas shkakimit të dëmit do të gjykojë kompensimin në një shumë që nevojitet që gjendja materiale e dëmtuesit të sjellet atje ku do të ishte po të mos kishte veprim dëmtues ose ometim”. Në rastin konkret shumë e mbuluar me Ujdi Jashtëgjyqësore prej 1,258.00 €, nuk është shumë e përgjithshme e dëmit, andaj edhe ekziston obligimi i të paditurës në kompensimin pjesës të mbetur, gjegjësisht shumës prej 6,637.50 €.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,
Ae.nr.298/2016,dt. 26.02.2018**

**KRYETARI I KOLEGJIT,
MahirTutuli,d.v.**